



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 13309 Akti

Datë. Regj 17.06.2021

V E N D I M
“PËR SIGURIMIN E PADISË”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE TEUTA HOXHA

Me sekretare gjyqësore Nadire Balla në datë 22.07.2021 çështjen civile Nr. 13309 Akti që u përket:

PADITES: Anna Xheka –Frob e bija e Sem dhe Sofie, dtl 23.02.1970 lindur në Bilisht Korçë dhe banues Lagjia Nr.17, Rr: “Drejtësia”, Nr.16, Durrës., përfaqësuar në gjykim nga Av. Brixhilda Jaupaj.

TE PADITUR : Shoqëria “Energy Albania Group” SHPK (EAG) SHPK me NIPT L01718504C me seli në Tiranë Rr. ‘Sulejman Delvina” pall 43/1 Kati i dytë Ap.1 Tiranë
Shoqëria “ ETRA” s.r.l, me adresë Calle Seconda II del Campello, 7 30026 Portogruaro Venezia, Itali.
Shoqëria Ghiggia Ingegneria D’impianti s.r.l Rruga Vittorio Veneto, 30/A 10010, Scarmagno-Torino-Itali.
Shoqëria “MP-HEC” shpk me NIPT k93826001D me seli në Tiranë Rr. “Sulejman Delvina” pall 43/1 Kati i dytë Ap.1 Tiranë

OBJEKTI: Anullimi kontratës së shit-blerjes së kuotave Nr.625 Rep dhe Nr.258 Kol date 11.07.2016 dhe i kontratës rrjedhese te saj Nr.9368 Rep dhe Nr.6678 Kol date 26.10.2018.
Zgjidhja e kontratës se shit-blerjes së kuotave Nr.625 Rep dhe Nr.258 Kol date 11.07.2016 dhe i kontrates rrjedhese te saj Nr.9368 Rep dhe Nr.6678 Kol date 26.10.2018.

Brixhilda Jaupaj



[Handwritten signature]

Fshirja e kontratës së shit-blerjes së kuotave Nr.625 Rep dhe Nr.258 Kol date 11.07.2016 dhe i kontratës rrjedhëse të saj Nr.9368 Rep dhe Nr.6678 Kol date 26.10.2018

Pagimi i pagës së paditëses në pozicionin e ish administrator të shoqërisë "MP-HEC" Shpk dhe "EAG" SHPK

Marrja e masës së sigurimit të padisë duke bërë bllokimin në QKB të kuotave të kapitalit të shoqërisë "EAG" Shpk për efekt të mostjetërsimit të tyre.

Marrja e masës së sigurimit të padisë duke bllokuar llogaritë bankare të shoqërive "MP-HEC" Shpk në të gjitha bankat e nivelit të dytë

Baza ligjore:

Neni 202 i K.PR Civile. Neni 94 e vijues i K.Civil Nenet 90 e vijues të KCivil, ; Nenet 659 e vijues të K.Pr.Civile.Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kontrata e shit-blerjes së kuotave Nr.625 Rep dhe Nr.258 Kol date 11.07.2016 dhe i kontrata rrjedhëse të saj Nr.9368 Rep dhe Nr.6678 Kol date 26.10.2018

GJYKATA

Si u njoh me padinë dhe aktet bashkëlidhur, në shqyrtim të kërkesës për sigurimin e padisë caktoi séance degjimore duke urdhëruar njoftimin e palës së paditur; Pala e paditur "EAG" Shpk dhe Shoqëria MP HEC shpk kanë selinë në të njëjtën adresë dhe njoftimet respektive kryer nëpërmjet ftesit gjyqësor nuk janë pranuar të merren dhe nënshkruhen nga personat që janë gjendur në selitë e këtyre shoqërive dhe në këto kushte, gjykata ka proceduar mungesë të tyre për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë ;

Dhe si u njoh provat shkresore;

KONSTATON

I.Paditësja Anna Xheka Frob është themeluese e shoqërisë "Energy Albania Group" SHPK (EAG Shpk) me NIPT L01718504C me seli në Tiranë , regjistruar rregullisht në QKB me ortakë të vetme Anna Xheka , zotëruese e një kuote me 100 % të kapitalit të saj dhe objekt veprimtarie "Importimin e impjanteve dhe pajisjeve për prodhimin e energjisë elektrike...".

Shoqëria "EAG" Shpk ka themeluar shoqërinë "MP-HEC" Shpk duke zotëruar 1 kuotë me 100 % të kapitalit të saj .

Me kontratën nr. 625 rep dhe 258 kol datë 11.07.2016 paditësja Anna Xheka i ka shitur dhe transferuar pjesët e kuotës , përkatësisht palëve të paditura Shoqëria Ghiggia Ingegneria D'iampianti s.r.l dhe Shoqëria "ETRA" s.r.l respektivisht secilës 45 % të kapitalit themeltar të shoqërisë (nj epjese të kuotes) tranferim i kryer kundrejt një çmimi sa vlera nominale e kuotave

Brixhilda Jovaj

të kapitalit regjistruar në QKB. Pas këtij transaksioni "EAG" Shpk zotërohej nga tre ortakë, me kapital të strukturuar në këtë mënyrë: Anna Xheka =1 Kuotë me 10 % të kapitalit; Shoqëria Ghiggia Ingegneria D'impianti s.r.l = 1 kuotë zotëruese e 45% të kapitalit , "ETRA" s.r.l me 45 % të kapitalit.

Kontrata në lërsi përmban një sërë të drejtash dhe detyrimesh për palët ndërgjyqëse .

Në nenin 2.1.d të kontratës palët kanë përcaktuar shprehimisht: " Pala blerëse dhe shoqëritë mbajtëse të detyrimit në vijim, "EAG" Shpk dhe "MP-HEC" Shpk për t'i garantuar palës shitëse respektimin e kësaj të drejte, kanë detyrimin që brenda 10 ditëve nga momenti i regjistrimit të kësaj kontratën e QKR , të mbledhin Asambletë respektive të Shoqërisë dhe të marrin vendim për nënshkrimin e kontratave respektive të detyrimit, t'i nënshkruajnë këto kontrata me të njëjtat kushte të kësaj kontrate, për njohjen dhe transferimin e detyrimeve të kësaj kontrate , tek shoqëria "Energy Albanina Group" Shpk dhe në vijim tek shoqëria MP-HEC SHPK e cila do të jetë shoqëria Finale që do t'i përmbushë ato. Në të kundërt pala shitëse me një njoftim drejtuar blerësit, ka të drejtë të bëjë anulimin e menjëhershëm të kësaj kontrate dhe pala blerëse detyrohet të paguajë dëmin e shkaktuar".

Kontrata në fjalë parashikonte dhe rregullonte edhe kushtet dhe mënyrën se si do t'i kthehej paditëses vlera e investimit të saj deri në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes, duke përcaktuar ndër të tjera në pikën 2.1 (b) se kjo vlerë investimi do t'i kthehej për një periudhë 28 vjeçare në formën e një tarife mujore , e cila do të fillonte të paguhej në momentin që do të vihej në punë hidrocentrali i ndërtuar nga koncesionaret "EAG" Shpk dhe bija e saj "MP-HEC" shpk

Me kontratën nr .9368 rep dhe 6678 kol datë 26.10.2018 paditësja Anna Xheka iu ka transferuar palëve të paditura Shoqëria Ghiggia Ingegneria D'impianti s.r.l dhe Shoqëria "ETRA" s.r.l edhe pjesëmarrjen e mbetur prej një kuote në vlerën 10 % të Shoqërisë "EAG" SHPK , duke i transferuar shoqërive të mësipërme secilës nga 5% të kapitalit dhe përfundimisht secili nga blerësit të paditurit Shoqëria Ghiggia Ingegneria D'impianti s.r.l dhe Shoqëria "ETRA" s.r.l në shoqërinë "EAG" Shpk zotëron nga një kuotë me vlerë 50% të kapitalit.

Paditësja ka parashtruar se palët e paditura , nuk kanë marrë asnjëherë angazhimin për njohjen dhe përmbushjen e detyrimeve që vijnë nga dispozitat e kontratës datë 11.07.2016 , e veçanërisht nga neni 2.1.d e kontratës së sipërcituar, duke mos ndërmarrë asnjëherë veprimet e nevojshme për nënshkrimin e kontratave të trajtuara në klauzolën e sipërcituar. Nënshkrimi i këtyre kontratave do të garantonte paditësen ndër të tjera për përmbushjen e detyrimit financiar ndaj saj nga shoqëritë "EAG" SHPK dhe "MP-HEC" SHPK sipas përmbajtjes se kontrates ne klauzolat e tjera te saj.

Paditësja ka parashtruar në padi dhe në seancën degjimore se megjithëse kontrata përcaktonte detyrimin e palës blerëse për të nënshkruar të njëjtën kontratë me kompanitë respektive brenda

Brixhilda Jopej



10 ditëve, asnjëherë pala tjetër nuk ka marrë iniciativë të tillë. Në këto kushte paditësja ka parashtruar se i është drejtuar me njoftim shkresor palës tjetër për përmbushjen e këtyre detyrimeve në të kundërt do të anulonte kontratën e datës 11.07.2016 sipas përcaktimit eksplisit të saj, por në përgjigjen e tyre palët e paditura ndonëse angazhohen për njohjen e detyrimeve që burojnë nga neni 2.1(b) i kontratës, nuk kanë ndërmarre veprime ligjore për të realizuar nënshkrimin e kontratave për të cilat kanë marrë angazhimin sipas nenin 2.1 (d) të kontratës.

Paditësja ka shpjeguar se së fundmi ka rënë në dijeni të faktit se më datë 29.01.2021 shoqëritë ETRA srl dhe Ghiggia Ingegneria D'Impianti s.r.l i kanë shitur duke i tjetërsuar shoqërisë Kilowatt Company Srl respektivisht secila nga 40% të kuotave të kapitalit në vlerën e tyre nominale në shoqërinë "EAG" SHPK. Në këtë mënyrë shoqëria "EAG" SHPK dhe për rrjedhojë MP-HEC Shpk, bija e saj e kontrolluar 100% nga EAG shpk, kontrollohen nga shoqëri e tretë e cila nuk është pjesë e kontratës së datës 11.07.2016 dhe për pasojë ekziston rreziku real i shmangies së detyrimeve që kanë ndaj saj Shoqëritë EAG Shpk dhe "MP-HEC" Shpk

Paditësja parashtron se në këtë mënyrë shoqëria "EAG" Shpk, zotërohet në masën 80% të kapitalit nga një shoqëri tjetër, dhe ekziston rreziku të shmanget përmbushja në tërësi e detyrimeve të marra përsipër nga të paditurit me kontratën e datës nr. 625 rep dhe 258 kol datë 11.07.2016, dhe në këto kushte kërkohet marrja e masës së sigurimit të padisë dhe vendosja e sekuestros konservative në QKB mbi kuotat e shoqërisë EAG Shpk për efekt të mostjetërsimit të tyre.

Përveç sa më lart, paditësja ka pretenduar se ka ushtruar detyrën e administratores së shoqërive "EAG" SHPK dhe "MP-HEC" Shpk dhe për periudhën 17.06.2018 deri 14.01.2020 nuk është paguar për këtë detyrë, dhe kërkon pagimin e pagës së administratorit për këtë periudhë në vlerën 1,248,000 lekë si dhe kërkon bllokimin e llogarive të dy shoqërive në "EAG" Shpk dhe "MP-HEC" Shpk në të gjitha bankat e nivelit të dytë deri në vlerën e mësipërme. Paditësja ka parashtruar se për shkak të sëmundjes së saj ka qenë në vështirësi të mëdha financiare, dhe pavaresisht kësaj gjendjeje palët e paditura nuk kanë përmbushur detyrimet për pagimin e pagës së saj si administratore.

Lidhur me këtë paditësja ka paraqitur konfirmimin nga Instituti i Sigurimeve shoqërore Tiranë për masën e pagës për të cilën janë derdhur kontributet si dhe kopje të ekstraktit të llogarive bankare.

II. Ligji i zbatueshëm

.Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile përcakton *rastet ligjore* se kur mund të vendosen masat e sigurimit të padisë duke parashikuar se:

Brixhi Ida Jaupej

"Me kërkesën e paditësit, gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sigurimi i padisë lejohe kur:

a) padia mbështetet në prova me shkresë;

b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund të shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni."

Në vijim, në nenin 203 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet ndër të tjera se sigurimi i padisë lejohe për të gjitha llojet e padive dhe në çdo fazë të gjykimit, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

Neni 204 të K.Pr.Civile parashikon shprehimisht se: "Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe para ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia.

Në këtë rast, gjykata cakton një afat jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë".

Sa i përket llojit të masave që mund të vendosë gjykata për sigurimin e padisë ato parashikohen por jo në mënyrë shteruese në nenin 206 të Kodit të Procedurës Civile në të cilin përcaktohet qartë se:

"Sigurimi i padisë bëhet:

a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit;

b) me marrjen nga ana e gjykatës të masave të tjera të përshtatshme, duke përfshirë edhe pezullimin e ekzekutimit.

Gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë.

Sekuestër nuk mund të vihet mbi sende që, sipas nenit 529 të këtij Kodi, nuk mund të sekuestrohen."

Gjykata

Në analizë të pretendimeve të paraqitura në kërkesë, të para në funksion të ligjit të zbatueshëm dhe rrethanave të çështjes vëren se:

III.Kërkesa për sigurimin e padisë nuk përbën një gjykim themeli, por një gjykim me qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e garancisë së një gjykimi efektiv, nëpërmjet të cilit të drejtat e fituara nëpërmjet vendimit përfundimtar në gjykimin e themelit, të mund të rivendosen në gjendjen e mëparëshme në mënyrë të plotë duke u siguruar në këtë mënyrë zbatimi i vendimit të dhënë.

Brixhi Ida Jovpa

REPUBLICA E SHqipëRIE
GJYKATA E TIRANES
TIRANË
5

Kërkesa për sigurimin e padisë e paraqitur para ngritjes së saj apo njëkohësisht me padinë duhet të përcaktojë qartë rrethin e të drejtave subjektive të pretenduara të shkelura si dhe të përcaktojë kërkimin konkret të paditësit (aktual apo të ardhshëm) .

Një kërkesë për sigurimin e padisë ka si parakusht të saj argumentimin ligjor dhe faktik se ekziston një e drejtë e ligjshme e pretenduar si e cënuar dhe që eventualisht mund të pranohet si e tillë nga gjykata në vendimin e saj përfundimtar, por realizimi i kësaj të drejte nëpërmjet ekzekutimit mund të rrezikohet dhe mos sjellë për pasojë rivendosjen e realisht në vend të drejtave të cënuara .

Në këtë këndvështrim nëpërmjet masës së sigurimit të padisë synohet kryesisht që të mbahet e ngrirë gjendja faktike e mosmarrëveshjes, derisa gjykata të zgjidhë përfundimisht çështjen në themel. Vendimi i dhënë me këtë rast, nuk paragjykon zgjidhjen në themel të çështjes, por synon thjesht që të mbajë një situatë konstante, që mundëson eventualisht ekzekutimin e vendimit përfundimtar. Në këto kushte nëpërmjet masës së sigurimit të padisë gjykata garanton në mënyrë paraprake por indirekte, zbatimin e vendimit të saj përfundimtar në eventualitet të shpalljes gjyqfitues të personit me kërkesë të të cilit aplikohet kjo masë.

Por, nga ana tjetër gjykata mban parasysh faktin se rastet e vendosjes së masave të sigurimit të padisë janë të përcaktuara shprehimisht në ligj dhe gjykata nuk mund të tejkalojë kufijtë e tij.

IV. Nga shqyrtimi i padisë, provave të paraqitura dhe nga shpegimet e paditëses para gjykatës, gjykata krijon binden se ekzistojnë kushtet ligjore për të proceduar me marrjen e masës së sigurimit të padisë , referuar nenit 202/2 të K.Pr.Civile, dhe se ekzekutimi i vendimit përfundimtar për të drejtat e paditëses mund të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Nga ana tjetër gjykata çmon se në këtë rast padia e paraqitur mbështetet në prova shkresore përmbajtja e të cilave është përshkruar më lart, të tilla që e justifikojnë marrjen e masës së sigurimit të padisë, por analiza e vlerës provuese të tyre vlerësohet të shmanget me qëllim mosparagjykimin e themelit të çështjes.

Në rrethanat e mësipërme, gjykata vlerëson së me qëllim që të sigurohet zbatimi i vendimit përfundimtar në eventualitet të pranimit të padisë për të drejtat e cënuara ndaj paditëses, të pranojë kërkesën e paraqitur për sigurimin e padisë nëpërmjet vendosjes së sekuestros konservative në kuotat e kapitalit të e shoqërive "EAG" Shpk dhe "MP HEC" shpk.

Lidhur me kërkesën për vendosjen e sekuestros konservative në llogaritë bankare të këtyre dy shoqërive, gjykata çmon se nuk ekziston rreziku i moszekzekutimit të vendimit përfundimtar në rast të shpalljes gjyqfitues të paditëses lidhur me pretendimet e saj sa i përket pagës së administratores së shoqërive për periudhën e pretenduar, për rrjedhojë nuk ka vend për marrjen e masës së sigurimit për këtë kërkim të padisë.

PËR KËTO ARËSYE

Brixhilda Jaupaj

Gjykata, bazuar në nenet 202 e vijues të K. Pr. Civile;

VENDOSI

- ✓ Pranimin e pjesëm të kërkesës për sigurimin e padisë.
- ✓ Vendosjen e sekuestros konservative mbi kuotat e kapitalit të shoqërive "Energy Albania Group" SHPK (EAG) SHPK me NIPT L 01718504 C dhe Shoqërisë "MP-HEC" shpk me NIPT K 193826001 D dhe ndalimin e tjetërsimit të tyre deri në përfundim të gjykimit të çështjes.
- ✓ Mospranimin e kërkesës për vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë bankare të "Energy Albania Group" SHPK (EAG) SHPK "MP-HEC" shpk.
- ✓ Kundër këtij vendimi mund të behet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 5 ditëve afat që fillon nga dita e nesërme njoftimit të vendimit nga sekretaria gjyqësore.

U shpall në Tiranë më 22.07.2021 ora 11 e 30.

SEKRETARE

Nadire Balla



GJYQTARE

Teuta HOXHA



VËRTETOHET NJESIA
ME ORIGJINALIN

K/ SEKRETARE
ADELA ÇINARI

Adela Çinari

PULLE TARIFE



Brishtila Jorgji, Tirane

me

22.07.2021